



Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000– Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Rregulla mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve)

Përmbajtja

KAPITULLI 1	Dispozitat e Përgjithshme	1
KAPITULLI 2	Dorëzimi dhe Aprovimi i Tarifave të rregulluara	3
KAPITULLI 3	Tarifat për Shitjen e Energjisë Elektrike Furnizuesit Publik	7
KAPITULLI 4	Tarifat për Shitjen e Energjisë Elektrike nga Furnizuesi Publik	7
KAPITULLI 5	Tarifat e Transmisionit (Bartjes)	8
KAPITULLI 6	Tarifat e Distribuimit (Shpërndarjes)	9
KAPITULLI 7	Detyrimet e Shërbimit Publik	10
KAPITULLI 8	Kostot e mbetura	10
KAPITULLI 9	Vendimet	11
KAPITULLI 10	Dispozitat Përfundimtare	16

KAPITULLI 1

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Hyrje

- 1.1 Sipas autoritetit të dhënë në përputhje me Kapitullin 9 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Nr. 2004/9, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në seancën publike më 15 Dhjetor 2005 miratoi Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kosovë (“Rregullën”).

Neni 2

Shtrirja dhe Qëllimet

- 2.1 Kjo Rregull përcakton parimet për llogaritjen dhe aprovimin e tarifave të rregulluara në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, dhe procedurat për dorëzim, shqyrtim, modifikim, aprovim dhe mbikëqyrje të tarifave të rregulluara nga ndërmarrjet energjetike.
- 2.2. Qëllimet e kësaj Rregull janë të vendosin afatet kohore, kushtet dhe procedurat në lidhje me tarifën, në mënyrë që të sigurojnë:
- 2.3 Funksionimin transparent dhe jo-diskriminues të tregut energjetik, bazuar mbi parimet e tregut të lirë;
- 2.4 Përbushjen transparente dhe jo-diskriminuese të aktiviteteve energjetike që janë subjekt i detyrimeve të shërbimeve publike;
- 2.5 Që çmimet për aktivitetet e rregulluara energjetike, të jenë të arsyeshme dhe të pandryshueshme, të bazuara në parimet e metodologjisë së tarifave;
- 2.6 Që interesat midis konsumatorëve dhe ndërmarrjeve energjetike të jenë të balancuar si duhet;
- 2.7 Që zbatimi i masave të përshtatshme të forcojë kohezionin social dhe ekonomik në gjithë Kosovën;
- 2.8 Sigurinë e furnizimit me energji elektrike përmes mirëmbajtjes dhe ndërtimit të kapaciteteve të nevojshme prodhuese dhe transmetuese, dhe infrastrukturës së rrjetit, duke përfshirë kapacitetin ndërlidhës;
- 2.9 Mbrojtjen e konsumatorëve përmes promovimit të qasjes transparente dhe të hapur në informacion, në lidhje me çmim-vënien dhe tarifën.

Neni 3

Parimet

- 3.1 Tarifën e aprovuar në përputhje me këtë Rregull, do të pasqyrojnë parimet e paraqitura në Nenin 46 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe do të konfirmojnë qëllimet e Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe Ligjin mbi Energjinë, që:
 - a) Çmimet duhet të jenë të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara mbi kritere objektive, dhe të përcaktuara në mënyrë transparente;
 - b) Çmimet do të varen së pari nga kostot e justifikuara, duke përfshirë kostot e pambuluara të bllokuara, në lidhje me tranzicionin në një treg konkurrues energjetik, duke përfshirë një kthim të arsyeshëm të investimeve;

- c) Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të lejohet të vendosë shkallë tarifore të bazuara në performancë;
- d) Çmimet duhet të marrin në konsideratë shqetësimet për mbrojtjen e ambientit dhe të konsumatorëve;
- e) Çmimet për grupet individuale të konsumatorëve do të përputhen me kostot e furnizimit me energji elektrike të këtyre konsumatorëve;
- f) Subvencionet e kryqëzuara të grupeve të konsumatorëve nuk do të lejohen;
- g) Subvencionet e kryqëzuara të aktiviteteve të ndërmarrjeve të integruara, nuk do të lejohen;
- h) Do të inkurajohen shkallët tarifore të ndërprera, normat e balancimit të ngarkesës dhe mekanizma të tjerë për të përmirësuar efikasitetin energjetik dhe menaxhimin e kërkesave, përfshirë shqyrtimin e zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- i) Shkallët tarifore sezonale dhe të kohës së përdorimit, lejohen, me çmime të përshtatura sipas kostos së shërbimit në periudhën kulmore (pikut) dhe jo-kulmore (jo-pikut);
- j) Tarifat e kyçje mund të përfshihen për kyçje në rrjet ose për rritjen e dukshme të ngarkesës.

Neni 4

Përkufizimet dhe Interpretimet

- 4.1 Termat vijues të përdorur në këtë Rregull, do të kenë kuptimin si vijon:
- a) **“kostoja e kapitalit”** është vlera e përcaktuar për këtë qëllim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë si pjesë e shqyrtimit të çmimit, ose një shqyrtimi të tarifave të rregulluara të propozuara, dhe paraqesin koston e ndërmarrjes energjetike, për shkak të shtimit të ekuitetit dhe/ose financimit të borxhit për qëllime investimi;
 - b) **“Shqyrtim nga ekspertit”** ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 31 të kësaj Rregulloreje.
 - c) **“vlera aktuale”** është vlera e zbritur e rrjedhjeve neto të parave të gatshme me normën e zbritjes, për qëllimet e paragrafit 13.2, ku bëhet e barabartë me koston e kapitalit të ndërmarrjes energjetike në fjalë;
 - d) **“periudha e kontrollit të çmimit”** është periudha midis shqyrtimeve të çmimeve;
 - e) **“Shqyrtimet e çmimeve”** është shqyrtimi dhe rivendosja e vlerës fillestare për çmimin maksimal, të ardhurat e lejuara dhe/ose shqyrtimi dhe përcaktimi i rregullimeve brenda kësaj periudhe, për ndërmarrjet energjetike, tarifat e të cilave rregullohen sipas normave të bazuara në performancë;
 - f) **“prodhuesi publik”** është një prodhues i përcaktuar në Nenin 8 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, dhe të cilit i është pranuar oferta për të furnizuar me energji elektrike [dhe/ose kapacitet] Furnizuesin Publik, në përputhje me këtë nen;
 - g) **“Udhëzimet Rregullatore mbi Kontabilitetin”** janë udhëzimet e nxjerra veçmas prej Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, me të cilat, ndërmarrjet energjetike janë të detyruara të jenë në përputhje, kur paraqesin kontabilitetin për qëllimet e shqyrtimit të çmimit dhe tarifave të propozuara;
 - h) **“shpenzimet e mbetura”** ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 18.6 të Ligjit mbi Energjinë.

- i) **“Kategori tarifore”** janë kategoritë e konsumatorëve që ngarkohen për pagese sipas komponentëve të njëjta tarifore;
 - j) **“komponentë tarifore”** është një pjesë individuale e një tarife, siç është pagesa për njësi të energjisë elektrike të konsumuar;
 - k) **“pagesat (taksat) për shfrytëzimin e sistemit”** ka kuptimin e atyre tarifave që aplikohen për qasje në rrjet ose për shfrytëzim të rrjetit të transmisionit (bartjes) ose të distribuimit (shpërndarjes), apo si ndërlidhës për qëllim të transportimit të energjisë elektrike.
 - l) **“rregullimet brenda periudhës”** është llogaritja e rritjeve të lejuara të maksimumit të çmimit ose të të ardhurave vjetore, që do të ngarkohen prej ndërmarrjes energjetike, dhe që tarifat e të cilave janë të rregulluara sipas normave të bazuara në performancë.
- 4.2 Termat e tjerë në këtë rregullore do të kenë kuptimin e specifikuar në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Ligjin mbi Energjinë ose në Ligjin mbi Energjinë Elektrike.
- 4.3 Për qëllimet e kësaj Rregulle, termi “konsumator” do të interpretohet si konsumatorë ekzistues dhe të ardhshëm.

KAPITULLI 2

Dorëzimi dhe Aprovimi i Tarifave të rregulluara

Neni 5

Tarifat e rregulluara

- 5.1 Tarifat e rregulluara janë ato tarifa që aplikohen nga:
- a) Një prodhues publik që i shet energji elektrike tek Furnizuesit Publik;
 - b) Furnizuesi Publik për shitjen e energjisë elektrike konsumatorëve jo të privilegjuar.
 - c) Ndërmarrjet energjetike të angazhuara në transmisionin (bartjen) ose distribuimin (shpërndarjen) e energjisë elektrike për përdorim të rrjeteve transmetuese dhe rrjeteve shpërndarëse.
- 5.2 Në përputhje me Nenin 47 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë mund të lirojë një ndërmarrje energjetike prej kërkesave për të marrë aprovimin e tarifave të rregulluara, nëse ndodh që ndërmarrja të veprojë në një treg konkurrues.

Neni 6

Normat e bazuara në performancë

- 6.1 Kur përdoren shkallët tarifore e bazuara në performancë, shqyrtimet e çmimeve për të përcaktuar maksimumin e lejuar të të ardhurave ose çmimeve do të bëhen me intervale që do të përcaktohen prej ZRrE-së. Gjatë periudhës së kontrollit të çmimeve, tarifat e rregulluara që janë në përputhje me këto maksimume do të dorëzohen për aprovim në përputhje me kushtet për rregullimet brenda periudhës së caktuar.

Neni 7

Shqyrtimet e çmimeve

- 7.1 Një shqyrtim çmimi do të bëhet në intervale të përcaktuar prej ZRrE-së dhe të specifikuar në vendimin që ka të bëjë me shqyrtimin më të fundit mbi çmimin e mëparshëm, për ndërmarrjen energjetike në fjalë. Për ato ndërmarrje energjetike për të cilat nuk është ndërmarrë asnjë shqyrtim i mëparshëm çmimi, ZRrE-ja mund të zgjedhë të fillojë një shqyrtim çmimi në çdo kohë.
- 7.2 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të publikojë një njoftim në faqen e saj zyrtare të internetit për fillimin e shqyrtimit të çmimeve dhe që ndërmarrjet energjetike të përfshihen në procesin e shqyrtimit të çmimeve, apo do të bëjë njoftimin në një mënyrë tjetër që konsiderohet e përshtatshme.
- 7.3 Qëllimi i shqyrtimit të çmimeve është të përcaktojë të ardhurat e lejuara maksimale apo çmimet që mund të mbulohen nga tarifat e rregulluara nga ndërmarrja energjetike që kanë të bëjnë me periudhën e ardhshme të kontrollit të çmimeve.
- 7.4 Shqyrtimi i çmimit përmban vlerësimin e kostove të arsyeshme dhe faktorëve të produktivitetit, duke përfshirë përdorimin e krahasuesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, sipas nevojës dhe përcaktimin e standardeve të performancës që do të përfshihen në normat e bazuara në performancë, për ndërmarrjet energjetike në fjalë.
- 7.5 Do të lejohet një kohë e përshtatshme për dorëzimin e informacionit prej ndërmarrjes energjetike tek ZRrE-ja, me qëllim që të realizohet shqyrtimi i çmimeve. Koha minimale e lejuar, do të jetë së paku [30] ditë. Është e drejtë e ZRrE-së të zgjasë këtë afat në raste kur informatat e kërkuara janë veçanërisht komplekse, të jashtëzakonshme apo në anën tjetër është vështirë të sigurohen.
- 7.6 ZRrE-ja do të nxjerrë një vendim që pason përfundimin e shqyrtimit të çmimit, i cili përcakton kostot që do të mbulohen prej ndërmarrjes energjetike gjatë periudhës së ardhshme të kontrollit të çmimeve, dhe duke përfshirë çdo faktor produktiviteti dhe standardet e përmbushjes që do të aplikohen.
- 7.7 Vendimi do të nxirret jo më vonë se [70] ditë përpara fillimit të datës së propozuar për periudhën e re të kontrollit të çmimeve.
- 7.8 Kur ZRrE-ja nuk arrin të nxjerrë një vendim, atëherë do të vazhdojnë të aplikohen dispozitat e vendimit më të fundit mbi shqyrtimin e çmimeve. Në rast se nuk ka pasur një shqyrtim paraprak për çmimin, atëherë ndërmarrja energjetike do të autorizohet për aprovimin e tarifave të propozuara prej saj, me të njëjtën mënyrë sikur të mos ishte subjekt i shkallëve tarifore të bazuara mbi performancën.

Neni 8

Dorëzimi i tarifave të propozuara

- 8.1 Ndërmarrjet energjetike do të dorëzojnë çdo vit në ZRrE tarifat e propozuara.
- 8.2 ZRrE-ja do të publikojë shpalljen për pranimin e dorëzimit të tarifave të propozuara në faqen e saj zyrtare të internetit dhe format tjera të njoftimit që konsiderohen të përshtatshme. Kopja e dorëzuar, bashkë me materialin mbështetës, do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ZRrE-së, duke përjashtuar ndonjë material të identifikuar si

- material komercial konfidenciale nga entiteti që bën dorëzimin, dhe i cili është i pranuar nga ZRrE-ja.
- 8.3 Tarifat e propozuara duhet të dorëzohen të paktën [60] ditë para datës së propozuar të fuqizimit për ndërmarrjet energjetike të parregulluara sipas shkallëve tarifore të bazuara në performancë, dhe të paktën [40] ditë përpara datës së propozuar të fuqizimit të ndërmarrjeve energjetike të rregulluara sipas shkallëve tarifore të bazuara në performancë.
- 8.4 Data e propozuar e fuqizimit nuk do të jetë më pak se 12 muaj pas datës së fuqizimit të tarifave më të fundit të aprovuara.
- 8.5 Ndërmarrjet energjetike të rregulluara sipas shkallëve tarifore të bazuara në performancë, do të dorëzojnë një propozim të ri për tarifa, me një datë të propozuar të hyrjes në fuqi të periudhës së re të kontrollit të çmimeve, pas një shqyrtimi çmimi për atë ndërmarrje energjetike, që realizohet nga ZRrE-ja.
- 8.6 Për ndërmarrjet energjetike të angazhuara në shitjen e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik, ose që bëjnë furnizimin publik me energji elektrike, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, nëse e konsideron më të përshtatshme, mund të përcaktojë afate tjera të dorëzimit, duke e zëvendësuar procedurën e përmendur në seksionin 8.3 më sipër. Këto përcaktime do të specifikohen në vendimin më të fundit të ZRrE-së në lidhje me tarifrat e rregulluara për ndërmarrjen energjetike në fjalë.
- 8.7 Kur paraqitet një propozim i tarifave, çdo ndërmarrje energjetike do të dorëzojë një justifikim për tarifrat e propozuara, duke përfshirë së paku:
- a) Programin për tarifrat e propozuara së bashku me datën e propozuar të fuqizimit;
 - b) Sasitë aktuale të furnizuara ose të transportuara, si të jetë më e përshtatshme, për çdo kategori konsumatorësh për 12 muajt e mëparshëm;
 - c) Tarifrat aktuale që aplikohen për çdo kategori konsumatorësh;
 - d) Informacione të tjera që ndërmarrja energjetike i konsideron se mund të mbështesin aplikimin e saj për aprovim të tarifave të propozuara.
- 8.8 Kur një ndërmarrje energjetike rregullohet sipas tarifave të bazuara në performancë, ajo duhet të dorëzojë prova që demonstrojnë përputhshmërinë e tarifave të veta të propozuara me vendimin më të fundit në lidhje me kontrollin e çmimit për ndërmarrjen në fjalë, duke marrë parasysh rregullimet brenda periudhës së caktuar.
- 8.9 Kur një ndërmarrje energjetike nuk rregullohet sipas tarifave të bazuara në performancë, duhet të paraqesë prova të kostos së saj për 12 muajt e mëparshëm dhe kostot e parashikuara për 12 muajt e ardhshëm, në formatin e specifikuar prej ZRrE-së në Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit. Ndërmarrja energjetike duhet të dorëzojë informacione shtesë të cilat justifikojnë çdo ndryshim midis kostove aktuale dhe atyre të parashikuara, ashtu siç e konsideron më të arsyeshme.
- 8.10 ZRrE-ja mund të kërkojë informacion shtesë me shkrim, përfshirë arsyet për kërkesën. Ky informacion duhet të dorëzohet prej ndërmarrjes energjetike tek ZRrE-ja brenda periudhës së përcaktuar në këtë kërkesë.
- 8.11 Çdo kërkesë e tillë duhet të bëhet brenda [15] ditësh prej marrjes së dorëzimit fillestar për aprovim të tarifave të propozuara të rregulluara, ose prej marrjes së informacionit shtesë si përgjigje ndaj kërkesës më të fundit, cilado qoftë më e fundit.

Neni 9

Rregullimet brenda periudhës së përcaktuar

- 9.1 Në rast se ZRrE-ja ka kërkuar përdorimin e shkallëve tarifore të bazuara mbi performancën, ndërmarrjet energjetike do të aplikojnë për aprovimin e tarifave të rregulluara të propozuara, pas aplikimit të parë të çdo periudhe të kontrollit të çmimeve, në përputhje me metodologjinë llogaritëse për rregullimet brenda periudhës së caktuar.
- 9.2 Metodologjia llogaritëse për rregullimet brenda periudhës së caktuar për një ndërmarrje energjetike do të përfshihet në vendimin në lidhje me shqyrtimin e çmimit për ndërmarrjen në fjalë.
- 9.3 ZRrE-ja mund të përfshijë kushtet si pjesë e metodologjisë llogaritëse për rregullimet brenda periudhës së caktuar për një shqyrtim të të gjithë kontrollit të çmimit, ose një pjesë të tij, në rast se vlerat aktuale për parametrat e identifikuar, lëvizin jashtë rangut të përcaktuar.

Neni 10

Modifikimi i tarifave

- 10.1 Kur një ndërmarrje energjetike kërkon modifikim të një kategorie tarifë ose komponentë tarifore, si pjesë e dorëzimit të tarifës në përputhje me Nenin 7, atëherë duhet të dorëzojë edhe:
 - a) Vlerësimet e numrit të konsumatorëve dhe sasive të furnizuara apo transportuara, që mund të kenë qenë ngarkuar për çdo kategori tarifore dhe komponentë tarifor, nëse ndryshimi i propozuar në këto të fundit, ka qenë në fuqi për më shumë se 12 muajt e fundit;
 - b) Vlerësimet e të ardhurave vjetore që mund të kenë qenë fituar sipas çdo kategorie tarifore dhe komponentë tarifore, në rast se ndryshimi i propozuar në kategoritë tarifore ose ndryshimit të komponentëve tarifore, ka qenë në fuqi për më shumë se 12 muajt e fundit;
 - c) Vlerësimet e numrit të konsumatorëve dhe sasive të furnizuara ose transportuara, që do të ngarkohen nën secilën kategori tarifore dhe komponentë tarifore për 12 muajt e ardhshëm, nëse ndryshimi i propozuar në kategori tarifore ose modifikimi i komponentëve tariforë është aprovuar;
 - d) Vlerësimet e të ardhurave vjetore që do të fitohen sipas secilës kategori tarifore dhe komponentë tarifore për 12 muajt e ardhshëm, nëse ndryshimi i propozuar në kategoritë e tarifore ose ndryshimet në komponentët tarifore, aprovohet;
 - e) Detajet dhe bazat për vlerësime të tilla.

Neni 11

Metodologjia e Tarifave

- 11.1 ZRrE-ja do të nxjerrë një metodologji për përlllogaritjen e tarifave të rregulluara prej ndërmarrjet energjetike, në përputhje me parimet e përmbajtura në këtë Rregullore, në formën e Metodologjisë së Tarifave.
- 11.2 Metodologjia e Tarifave do të rifreskohet prej ZRrE-së, sipas kërkesave.

KAPITULLI 3

Tarifat për Shitjen e Energjisë Elektrike Furnizuesit Publik

Neni 12

Tarifat e Prodhuesit Publik

- 12.1 Tarifat për shitjen e energjisë elektrike [dhe/ose kapacitetit] Furnizuesit Publik nga prodhuesit publikë, do të specifikohet në kontratat vjetore midis Furnizuesit Publik dhe çdo prodhuesi publik.
- 12.2 Këto tarifa do të lejojnë mbulimin e të gjithë kostove të arsyeshme të prodhuesve publikë, të lidhura me furnizimin e energjisë elektrike [dhe/ose kapacitetit] tek Furnizuesi Publik.
- 12.3 Në përcaktimin e tarifave në përputhje me këtë Nen, nuk do të merren parasysh të ardhurat vjetore të fituara prej prodhuesit publik prej shitjes së energjisë elektrike [dhe/ose kapacitetit], përveç sipas kontratës vjetore me Furnizuesin Publik.

Neni 13

Sasitë e Rregulluara

- 13.1 Furnizuesi Publik do të lejohet vetëm të blejë energji elektrike [dhe/ose kapacitet] prej prodhuesve publikë, me tarifa të rregulluara deri në një sasi të barabartë me atë që kërkohet për t'i shërbyer kërkesës së konsumatorëve jo të privilegjuar në çdo vit.
- 13.2 Çdo blerje që e tejkalon këtë shumë, do të jetë në tarifat e parregulluara, pavarësisht a janë prej prodhuesve publikë apo prodhuesve të tjerë.

KAPITULLI 4

Tarifat për Shitjen e Energjisë Elektrike nga Furnizuesi Publik

Neni 14

Konsumatorët jo të privilegjuar

- 14.1 Tarifat e ngarkuara nga Furnizuesi Publik për konsumatorët jo të privilegjuar për furnizimin e energjisë elektrike [dhe /ose kapacitetit], do të pasqyrojnë tarifat e rregulluara me të cilat Furnizuesi Publik blen energji elektrike prej prodhuesve publikë.
- 14.2 Kjo kërkesë nuk do të pengoj që këto tarifa të përbëjnë faktorë nxitës për Furnizuesin Publik që të zvogëlojnë kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe/ose kapacitetit për të shërbyer konsumatorët jo të privilegjuar.

Neni 15

Konsumatorët e privilegjuar

- 15.1 Tarifat e ngarkuara konsumatorëve të privilegjuar prej Furnizuesit Publik për furnizimin e energjisë elektrike dhe/ose kapacitetit, do të pasqyrojnë tarifën e parregulluar me të cilat furnizuesi publik blen prej prodhuesve, me sasi që tejkalojnë ato që nevojiten për t'u shërbyer kërkesave të konsumatorëve të privilegjuar.

Neni 16

Shpenzimet e Furnizuesit Publik

- 16.1 Tarifat e ngarkuara nga Furnizuesi Publik do të lejojnë rikthimin e të gjitha shpenzimeve të arsyeshme të Furnizuesit Publik të lidhura me furnizimin e konsumatorëve final me energji elektrike, duke përfshirë leximin e njehsorëve, faturimin, grumbullimin dhe dhënien e informacioneve mbi tarifën dhe shërbimet, pavarësisht a sigurohen drejtpërdrejtë nga Furnizuesi Publik apo nga ndonjë ndërmarrje tjetër në emër të Furnizuesit Publik.
- 16.2 Tarifat e ngarkuara do të lejojnë po ashtu rikthimin e çdo lloj kërkesë të shpenzimeve kapitale nga Furnizuesi Publik dhe t'i sigurohet Furnizuesit Publik një kthim i arsyeshëm për të kompensuar rrezikun e supozuar komercial.

Neni 17

Tarifa sociale

- 17.1 ZRrE-ja mund të kërkojë nga furnizuesi publik që të prezantojë ose të mbajë një kategori tarifore për shitjen e energjisë elektrike konsumatorëve shtëpiakë me të ardhura të ulëta, ose që konsumojnë sasi të vogla të energjisë elektrike. Tarifën e ngarkuara ndaj kësaj kategorie tarifore, mund të mos mbulojnë (të jenë më të vogla) kostot e furnizimit të energjisë elektrike këtyre konsumatorëve, ku diferenca ju kompensohet nga tarifën e konsumatorëve shtëpiakë me të ardhura më të larta ose që konsumojnë sasi më të mëdha energjie, tarifa këto që përcaktohen më lart se kostot e furnizimit të këtyre konsumatorëve.

KAPITULLI 5

Tarifat e Transmisionit (Bartjes)

Neni 18

Pagesat (taksat) e shfrytëzimit sistemit të transmisionit (bartjes)

- 18.1 Pagesat (taksat) e shfrytëzimit sistemit të transmisionit (bartjes), do të mbulojnë kostot e:
- Provizionin për ofrimin e shërbimeve të rrjetit të transmisionit (bartjes);
 - Provizionin për rrjetet ndihmëse, të nevojshme për funksionimin efektiv të rrjetit të transmisionit (bartjes); dhe
 - Kostot e Operatorit të Sistemit të Transmisionit (bartjes) të cilat nuk janë të lidhura me blerjen ose shitjen e energjisë elektrike, kapacitetit ose shërbimeve ndihmëse; të cilat nuk mbulojnë prej burimeve tjera.
- 18.2 Pagesat (taksat) e shfrytëzimit sistemit të transmisionit (bartjes) nuk do të mbulojnë kostot që lidhen me blerjen ose shitjen e energjisë elektrike, kapacitetit ose shërbimeve

ndihmëse prej Operatorit të Rrjetit Transmetues të shkaktuara nën përgjegjësinë e tij për operim të sigurt të sistemit të transmisionit (bartjes).

Neni 19

Pagesat (taksat) për kyçje në rrjetin e transmisionit (bartjes)

- 19.1 Pagesat (taksat) për kyçje në rrjetin e transmisionit (bartjes) do të mbulojnë kostot e:
- a) Kryerjes së punëve dhe instalimit të centralit elektrik, linjave, njehsorëve dhe pajisjeve të tjera për qëllimin e ndërtimit ose modifikimit të kyçjes të një impianti (objekti) elektrik ose konsumatori në rrjetin e transmisionit (bartjes), për aq kohë sa këto kosto nuk mbulohen në mënyra të tjera prej pagesave (taksave) të shfrytëzimit të sistemit të transmisionit (bartjes); dhe
 - b) Heqjes së centralit elektrik, linjave, njehsorëve dhe pajisjeve të tjera me qëllim të ç'kyçjes së një impianti (objekti) elektrik, ose konsumatori, prej rrjetit transmetues.

KAPITULLI 6

Tarifat e Distribuimit (Shpërndarjes)

Neni 20

Pagesat (taksat) për shfrytëzimin e sistemit të distribuimit (shpërndarjes)

- 20.1 Pagesat (taksat) për shfrytëzimin e sistemit të distribuimit (shpërndarjes), do të mbulojnë kostot e:
- a) Sigurimit të shërbimeve të rrjetit të distribuimit (shpërndarjes);
 - b) Sigurimit të rrjeteve ndihmëse, të nevojshme për funksionimin efektiv të rrjetit të distribuimit (shpërndarjes); dhe
 - c) Kostot e Operatorit të Sistemit të Distribuimit (Shpërndarjes);
- të cilat nuk mbulohen prej burimeve tjera.

Neni 21

Pagesat (taksat) për kyçje në rrjetin e distribuimit (shpërndarjes)

- 21.1 Pagesat (taksat) për kyçje në rrjetin e distribuimit (shpërndarjes) do të mbulojnë kostot e:
- a) Kryerjes së punëve dhe sigurimin si dhe instalimin e centralit elektrik, linjave, njehsorëve dhe pajisjeve të tjera, për qëllimin e ndërtimit ose modifikimit të kyçjes të një impianti (objekti) elektrik, ose konsumatori në rrjetin e distribuimit (shpërndarjes), për aq kohë sa këto kosto nuk mbulohen në mënyra të tjera pagesave (taksave) të shfrytëzimit të sistemit të distribuimit (shpërndarjes); dhe
 - b) Heqjes së centralit elektrik, linjave, njehsorëve dhe pajisjeve të tjera me qëllim të ç'kyçjes së një impianti (objekti) elektrik, ose konsumatori, nga rrjeti i distribuimit (shpërndarjes).

KAPITULLI 7

Detyrimet e Shërbimit Publik

Neni 22

Përcaktimi i Detyrimeve të Shërbimit Publik

- 22.1 Bordi i ZRRrE-së herë pas here, do të nxjerrë vendime që përcaktojnë:
- a) Ekzistencën e një Detyrimi të Shërbimit Publik;
 - b) Natyrën, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e Detyrimit të Shërbimit Publik; dhe
 - c) Ndërmarrjet energjetike për të cilat aplikohet Detyrimi i Shërbimit Publik.

Neni 23

Mbulimi i Kostove të Detyrimeve të Shërbimeve Publike

- 23.1 Çdo vendim në lidhje me Detyrimin për Shërbim Publik, do të përcaktojë se si do të përcaktohen kostot e atij detyrimi.
- 23.2 Ndërmarrjet energjetike do të autorizohen të mbulojnë kostot e Detyrimit të Shërbimit Publik, të përcaktuar në përputhje me vendimin përkatës, dhe që nuk janë mbuluar ose nuk priten që të mbulohen prej burimeve të tjera, përmes një Ngarkimi të Detyrimit të Shërbimit Publik.
- 23.3 Ngarkimi i Detyrimit të Shërbimit Publik mund të jetë ose një ngarkesë e aplikuar për disa ose të gjithë konsumatorët brenda të njëjtës kategori, si ata që përfitojnë prej kushtit të Detyrimit, vënies së taksave ose një ngarkimi të ngjashëm të aplikuar për të gjithë konsumatorët e elektricitetit.
- 23.4 Ngarkimi i Detyrimit të Shërbimit Publik do të identifikohet ndarazi në të gjitha faturat.

KAPITULLI 8

Kostot e Mbetura

Neni 24

Përcaktimi i kostove të mbetura

- 24.1 Bordi i ZRRrE-së do të nxjerrë një vendim ku deklarohet sasia totale e potencialit maksimal të kostove të mbetura, për çdo ndërmarrje energjetike që kualifikohet.
- 24.2 Sapo të përcaktohet potenciali maksimal i kostove të mbetura kjo nuk do të ndryshohet më.
- 24.3 Kostot reale të mbetura që do të mbulohen, do të përbëhen nga kostot e mbetura me potencial maksimal, duke i hequr të ardhurat vjetore të fituara nga shitja e energjisë dhe/ose kapacitetit.

Neni 25

Ngarkimi i Konkurrencës Kalimtare

- 25.1 Ndërmarrjet energjetike do të autorizohen të mbulojnë kostot e mbetura përmes një Ngarkimi të Konkurrencës Kalimtare.
- 25.2 Ngarkimi i Konkurrencës Kalimtare mund të jetë ose një ngarkim i aplikuar tek disa ose të gjithë konsumatorët e së njëjtës kategori, si ata që përfitojnë prej kushteve të Detyrimit, ose një vënie takse apo një ngarkim i ngjashëm, i aplikuar ndaj të gjithë konsumatorëve të energjisë elektrike.
- 25.3 Ngarkimi i Konkurrencës Kalimtare do të identifikohet ndarazi në të gjitha faturat.

KAPITULLI 9

Vendimet

Neni 26

Pjesëmarrja publike

- 26.1 Përpara se të merret vendimi për shqyrtimin e çmimeve ose shqyrtimin e mëposhtëm të tarifave të propozuara, Bordi i ZRrE-së do të sigurojë që është bërë provizion adekuat për pjesëmarrje publike në shqyrtim.
- 26.2 Pjesëmarrja publike do të përfshijë ndonjë nga pikat si më poshtë:
 - a) Një mundësi që palët të regjistrojnë në ZRrE interesimin e tyre për pjesëmarrjen në procesin e shqyrtimit.
 - b) Një periudhë kohore e arsyeshme për palët, në mënyrë që të kenë mundësi që të kërkojnë informata shtese nga ZRrE-ja apo nga ndërmarrja energjetike në fjalë.
 - c) Periudhë kohore e arsyeshme e lejuar për kërkesën e dorëzimit me shkrim nga palët për shqyrtim të çmimeve apo tarifave të propozuara në letër, dorëzimet dhe dokumente tjera të nxjerra nga ZRrE-ja, sa i përket ndërmarrjeve energjetike në fjalë apo përgjegjësve të tjerë;
 - d) Dëgjimet publike në format dhe për temat e përcaktuara nga ZRrE-ja, gjë që është kërkesë që i referohet nen-seksionit 26.7.
- 26.3 Pjesëmarrja publike mund të përfshijë poashtu:
 - a) Dëgjime publike të tjera nga ato që kërkohen në nen-seksionin 26.7, në formën dhe në lidhje me temën e shqyrtimit të çmimeve apo të tarifave të propozuara, ashtu siç do të përcaktohet nga ZRrE-ja;
 - b) Takimet mes përfaqësuesve të Zyrës Rregullative të Energjisë dhe ndërmarrjes energjetike, konsumatorëve apo palëve tjera të interesuara; dhe
 - c) Forma tjera të pjesëmarrjes që ZRrE-ja i konsideron të përshtatshme.
- 26.3.1 Kërkesat për informata nën nenin 26.2 b) do të dorëzohen duke u bazuar në procedurat e ndara që do të lëshohen nga ZRrE-ja mu për këtë qëllim. Këto procedura do të

përmbajnë kërkesat e duhura në mënyrë që të sigurohet se kërkesat janë të arsyeshme , dhe nuk do të shkaktojnë ngarkesë të panevojshme për ZRRE-në apo ndërmarrjen energjetike , dhe nuk kërkojnë që të publikohen informata konfidenciale komerciale .

- 26.4 Kur kërkohen dorëzime me shkrim, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të publikojë njoftimin për këtë në faqen e saj zyrtare të internetit dhe në mënyra tjera që konsiderohen të përshtatshme për të bërë të ditur njoftimin.
- 26.5 Nga dita e shpalljes për pranimin e dorëzimit me shkrim lejohet të kalojnë së paku (15) ditë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë, mundet, sipas gjykimit të vet, të zgjedhë që të pranojë dorëzime edhe pas kësaj date.
- 26.7 Në rast të shqyrtimit të çmimit në lidhje me tarifat e furnizuesit publik, do të jetë së paku një dëgjim publik. Nëse është e nevojshme ZRRE-ja do të mbajë dëgjimin publik në më shumë se një regjion gjeografik. Në të gjitha rastet tjera, nevoja dhe lokacioni i dëgjimeve publike do të jetë në vendimin e ZRRE-së.
- 26.8 Kur të mbahet dëgjimi publik, njoftimi për këtë do të jepet së paku (10) ditë para dëgjimit publik në faqen zyrtare të internetit të ZRRE-së, apo në mënyre tjetër që konsiderohet e përshtatshme për të bërë të ditur njoftimin.

Neni 27

Vendimet

- 27.1 Duke pasuar shqyrtimin e tarifave të propozuara, Bordi i ZRRE-së do të nxjerrë një vendim ku:
- a) Aprovohen tarifat e propozuara, ose
 - b) Aprovohen tarifat e propozuara me ndryshime, ose
 - c) Refuzohen tarifat e propozuara dhe i kërkohet ndërmarrjes energjetike të dorëzojë tarifat e rishikuara të propozuara.
- 27.2 Kur dorëzohet një aplikim i rishikuar, kushtet e seksionit 29.2 më poshtë, do të përlllogariten duke përdorur datën e dorëzimit të aplikimit origjinal.
- 27.3 Të gjitha vendimet e nxjerra sipas kësaj rregulloreje, do të përfshijnë një justifikim.
- 27.4 Bordi i ZRRE-së do të nxjerrë një vendim me afat më të vonë:
- a) Për ndërmarrjet energjetike të rregulluara, duke përdorur tarifat e bazuara në përmbushje, [15] ditë pas marrjes së dorëzimit të origjinalit;
 - b) Për ndërmarrjet energjetike të parregulluara, që përdorin tarifa të bazuara në përmbushje, [45] ditë pas marrjes së dorëzimit të origjinalit;
 - c) Për të gjitha ndërmarrjet energjetike të rregulluara, [15] ditë pas marrjes së informacioneve shtesë në përgjigje të kërkesës së fundit, në përputhje me paragrafin 8.10, më sipër.
- 27.5 Vendimi i Bordit të ZRRE-së do të merret parasysh për nxjerrje, në datën e botimit të tij në faqen zyrtare elektronike të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, përveç nëse vendimi përcaktohet ndryshe.

Neni 28

Botimi

- 28.1 Kopjet e vendimeve dhe tarifave të propozuara do të botohen në buletin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe në faqen zyrtare elektronike të ZRrE-së.
- 28.2 Evidencat, komentet, dorëzimet dhe dokumente të tjera të marra në lidhje me shqyrtimin e çmimit ose shqyrtimin e tarifave të propozuara, mund të botohen në faqen zyrtare elektronike të ZRrE-së, duke përjashtuar çdo material të identifikuar prej entit dorëzues, si sekret komercial dhe i pranuar si i tillë nga ZRrE-ja.

Neni 29

Efektiviteti

- 29.1 Tarifat e rregulluara të aprovuara do të bëhen efektive në datën e propozuar të efektivitetit ose [15] ditë pas nxjerrjes së vendimit, cilido qoftë ky i fundit.
- 29.2 Kur vonohet aprovimi i tarifave të rregulluara prej datës së propozuar të efektivitetit, për shkak të kërkesave për informacione shtesë në përputhje me paragrafin 8.10, më sipër, ose për shqyrtime eksperte apo për apelim kundër vendimit të ZRrE-së, në përputhje me Nenin 31 dhe 32 si më poshtë, atëherë:
- a) Tarifat e rregulluara të aprovuara do të rregullohen për të llogaritur ndryshimin në të ardhurat vjetore reale, dhe atyre që mund të ishin fituar nëse tarifat e rregulluara do të bëheshin efektive në datën e propozuar;
 - b) Rregullimi do të bazohet në vlerën aktuale të ndryshimit në të ardhurat vjetore si në datën e efektivitetit të propozuar në fillim.
- 29.3 Paragrafi 29.2, më sipër, nuk do të aplikohet kur vonesa ndodh për shkak të vonesave nga ana e ndërmarrjes energjetike në dorëzimin e informacionit shtesë të kërkuar nga ZRrE-ja, në përputhje me paragrafin 8.10, më sipër, dhe kur vlera aktuale e përlllogaritur në përputhje me paragrafin 29.2, më sipër, është pozitive.
- 29.4.1 Ndërmarrja energjetike do të botojë tarifat e rregulluara të aprovuara, në të paktën 2 gazeta ditore që qarkullojnë në Kosovë, të paktën 7 ditë përpara datës së efektivitetit. Ndërmarrjet energjetike gjithashtu do të botojnë tarifat e rregulluara të aprovuara në faqen e tyre zyrtare elektronike, po ashtu informatat për tarifat e aprovuara do të shpërndahen me anë të faturës së ardhme që do t'iu dorëzohet konsumatorëve 7 ditë para datës së efektivitetit të tarifave. Informatat e dhëna në këtë vërejtje do të lejojnë kohë të mjaftueshme që t'iu lejojnë konsumatorëve mundësin që të krahasojnë tarifat e më parme me tarifat e reja të aprovuara dhe ndikimin e këtyre tarifave te konsumatorët.

Neni 30

Rishikimi

- 30.1 Ndërmarrja energjetike apo konsumatori mund të kërkojë nga Bordi i ZRrE-se, rishikim të vendimit në lidhje me vendimin apo të aprovimit të tarifave të rregulluara apo shqyrtimin e çmimeve (15) ditë para lëshimit të vendimit.
- 30.2 Secila kërkesë për rishikim duhet të identifikojë se cilës pjesë apo cilave pjesë të vendimit po iu referohet dhe të jap arsyetim për kërkesën. Rishikimi mund të arsyetohet duke u bazuar si në vijim:
- a) Nëse ka evidencë të re e cila është esenciale në lidhje me vendimin për të cilin nuk kemi qenë në dijeni para lëshimit të vendimit;
 - b) Ka pas ndërrim esencial në ligj i cili ka lidhje me vendimin;
 - c) Ka pas ndonjë gabim në ligj apo në fakte të cilat janë esenciale për vendimin;apo

- d) Ka arsye të mirë për shqyrtim të mëtutjeshëm të çështjes në lidhje me vendimin.
- 30.3 Pas pranimit të kërkesës për rishikim ZRrE do të publikoj kërkesën në faqen e saj zyrtare të internetit dhe do të lejoj një periudhë kohore për palët tjera të bëjnë komente duke e sqaruar pozitën e tyre për kërkesë e bere .
- 30.4 Nëse Bordi i ZRrE-se konsideron se rishikimi është merituar , do të publikoj njoftimin për rishikim në faqen e saj zyrtare në internet apo në atë mënyrë që e konsideron si adekuate që të siguroj njoftimin për rishikim. Njoftimi do të identifikoj çështjet të cilat do të rishikohen dhe do të caktoj rishikimin
- 30.5 Nëse njoftimi nuk do të lëshohet brenda (15) ditëve të kërkesës për rishikim, atëherë kërkesa do të konsiderohet si e refuzuar.
- 30.6 Mundësia do të jetë për të gjitha palët që të dorëzojnë kërkesa të shkruara në çështjet të cilat janë në rishikim . Bordi i ZRrE-se mund të adoptoj format e tilla të pjesëmarrjes publike , siç janë identifikuar me lartë në nenin 26.2 dhe 26.3 nëse konsiderohen si të arsyeshme
- 30.7 Rishikim nuk do të vonoj lëshimin në fuqi të tarifave të rregulluara të aprovuara me vendimin origjinal .
- 30.8 Bordi i ZRrE-së do të lëshoj vendimin brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit në përputhje me nenin 30.4.

Neni 31

Shqyrtimet e ekspertëve

- 31.1 Një ndërmarrje energjetike apo konsumatorët mund të kërkojnë nga ZRrE-ja një Shqyrtim Ekspert të një vendimi në lidhje ose me aprovimin e tarifave të rregulluara, ose një shqyrtim çmimi brenda [15] ditësh pas nxjerrjes së vendimit.
- 31.2 Ndërmarrjet energjetike apo konsumatorët do të autorizohen të apelojnë vendimet në lidhje me shqyrtimin e çmimeve në të njëjtën mënyrë si për apelimet kundër vendimeve që lidhen me aprovimin e tarifave të rregulluara të propozuara.
- 31.3 Eksperti ose ekspertët që do të marrin përsipër Shqyrtimin Ekspert propozohen nga ndërmarrja energjetike apo konsumatori dhe aprovohen nga ZRrE-ja. Eksperti ose ekspertët duhet të përmbushin kushtet vijues:
- a) Të kenë kualifikime profesionale dhe/ose përvojë praktike në fushat e ekonomisë, financave dhe inxhinierisë në sektorin e energjisë;
 - b) Të kenë përvojë në rregullimin e tarifave dhe cilësisë së shërbimit për shërbimet komunale;
 - c) Të mos kenë interesa pronësie, marrëdhënie punësimi ose direkt ose përmes punonjësve të tjerë, të të njëjtit biznes me ekspertin në fjalë, as lidhje familjare me ndonjë person të ndërmarrjes energjetike në fjalë, me ndërmarrje energjetike në sektorin e energjisë në Kosovë, me ZRrE-në dhe me Vetë-qeverisjen e Përkohshme në Kosovë, dhe të mos kenë pasur interesa ose lidhje të tilla për një periudhë minimale prej të paktën 2 vjet përpara emërimit.
- 31.4 Eksperti ose ekspertët do të kenë qasje në të gjithë informacionin dhe dorëzimet e marra si pjesë e vendimit të parë. Atyre do t'u kërkohet që të nënshkruajnë një marrëveshje të

- përshtatshme për ruajtjen e besueshmërisë. Ndërmarrja energjetike apo konsumatori në fjalë dhe ZRRE-ja mund të sigurojnë informacione shtesë për ekspertin ose ekspertët.
- 31.5 Eksperti ose ekspertët, brenda [30] ditësh do të nxjerrin një raport ku paraqesin mendimin e tyre nëse:
- Vendimi i nxjerrë nga ZRRE-ja në lidhje me tarifat e rregulluara të propozuara ose me shqyrtimin e çmimeve, do të mbetet në fuqi nëse është i përshtatshëm;
 - Vendimi i nxjerrë nga ZRRE-ja duhet të ndryshohet pjesërisht; ose
 - Tarifat e rregulluara të propozuar që janë dorëzuar fillimisht prej ndërmarrjes energjetike në fjalë apo amendamentet e propozuara origjinale nga ana e konsumatorit duke kërkuar shqyrtimin e përshtatshëm, duhet të aprovohen dhe të zëvendësojnë vendimin e nxjerrë nga ZRRE-ja.
- 31.6 Raporti do të përmbajë arsyet e plota me shkrim për këtë mendim. Një kopje e raportit do të botohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.
- 31.7 [7] ditë pas marrjes së raportit që përmban mendimin e ekspertit/ëve, Bordi i ZRRE-së do të nxjerrë vendimin nëse duhet të:
- Pranojë opinionin e ekspertit ose ekspertëve të pavarur dhe të zëvendësojë vendimin e tij origjinal; ose
 - Refuzojë opinionin e ekspertit ose ekspertëve të pavarur dhe të mbajë vendimin e tij origjinal.
- 31.8 Çdo kosto, tarifa të këshilltarëve ose shpenzime që janë hasur gjatë shqyrtimit ekspert, do të hiqen ekskluzivisht nga ndërmarrja energjetike apo konsumatori që ka kërkuar shqyrtimin ekspert.

Neni 32

Apelimi në Gjyq

- 32.1 Ndërmarrjet energjetike ose konsumatorët, brenda afateve kohore të përcaktuar në legjislacioni civil të aplikueshëm në Kosovë, mund të apelojnë në gjykatat kompetente për anulimin e çdo vendimi që merret prej Bordit të ZRRE-së, pasi që është përfunduar shqyrtimi nga ekspertët.

KAPITULLI 10 Dispozitat Përfundimtare

Neni 33

Gjuha

- 33.1 Kjo rregullore do të nxirret në shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, do të mbizotërojë versioni në anglisht.
- 33.2 Vendimet së bashku me arsyet, do të nxirren në shqip, serbisht dhe anglisht. Nëse bëhet kërkesë, kopjet e vendimit duhet të vihen në dispozicion në të tre gjuhët. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, do të mbizotërojë versioni në anglisht.
- 33.3 Dokumentet e siguruar ose nxjerrë sipas kësaj rregulloreje përveç vendimeve të ZRRE-së, mund të jenë në ndonjë prej tre gjuhëve, shqip, serbisht apo anglisht.

Neni 34

Zbatimi dhe ndryshimi

- 34.1 ZRRE-ja, herë pas here, mund të nxjerrë udhëzim në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.
- 34.2 Ndryshimet në këtë rregullore, mund të fillohet prej ZRrE-së me iniciativë të saj, ose sipas kërkesës së ndërmarrjeve energjetike apo konsumatorëve.

Neni 35

Hyrja në fuqi

- 35.1 Kjo rregullore me përjashtim të nën seksionit 23.4 dhe 25.3, do të hyjë në fuqi në datën e botimit të saj në faqen zyrtare elektronike të ZRrE-së..
- 35.2 Nën seksionet 23.4 dhe 25.3 do të hyjnë në fuqi pas afatit të lejuar pasi të mund të njoftohen veçmas nga ZRrE-ja.

Neni 36

Dispozitat kalimtare

- 36.1 Në kohën e miratimit të kësaj rregulloreje, ZRrE-ja do të përcaktojë:
- a) Datën fillestare të efektivitetit për tarifat e para të rregulluara, të propozuara nga ndërmarrjet energjetike, në përputhje me Nenin 7, më sipër. Kjo datë mund të jetë e ndryshme për ndërmarrje energjetike të ndryshme;
 - b) Ato tarifa të rregulluara që janë çliruar nga kriteret për aprovim të ZRrE-së, në përputhje me paragrafin 5.2, më sipër.
- 36.2 Ndërmarrjeve energjetike do t'u kërkohet që të dorëzojnë aplikimet për aprovim të tarifave të rregulluara të propozuara, me një datë të propozuar të efektivitetit, të barasvlershme me datën fillestare të efektivitetit, siç përcaktohet nga ZRrE-ja në përputhje me paragrafin 36.1, më sipër.
- 36.3 Deri në kohën kur janë futur në fuqi tarifat e rregulluara, në përputhje me Nenin 29, më sipër, tarifat e rregulluara ekzistuese të ngarkuara prej ndërmarrjeve energjetike, do të mbeten në fuqi.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

Anëtarët e Bordit:
